VENDIM
Nr.931, datë 17.11.2010

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AZERBAJXHANIT, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE E TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike e të shërbimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AZERBAJXHANIT MBI HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Azerbajxhanit (më poshtë të quajtura "Palët kontraktuese");

të nisura nga dëshira për lehtësimin e hyrjes, daljes dhe lëvizjes së qytetarëve të tyre ndërmjet dy vendeve, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qytetarët e secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit mund të hyjnë, të qëndrojnë, të kalojnë tranzit dhe të largohen nga territori i palës tjetër kontraktuese pa vizë për një periudhë jo më të gjatë se 90 ditë brenda 180 ditëve nga data e hyrjes së parë.

Neni 2

Qytetarët e secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit, që janë pjestarë të stafit të misionit diplomatik ose postit konsullor apo të një organizate ndërkombëtare me seli në territorin e palës tjetër kontraktuese dhe pjesëtarët e familjes në ngarkim të tyre kanë të drejtë të hyjnë pa vizë në territorin e palës tjetër kontraktuese.

Neni 3

Qytetarët e secilit shtet ose palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit do të hyjnë, largohen dhe qëndrojnë tranzit në territorin e shtetit ose palës tjetër kontraktuse në çdo pikë të kalimit kufitar të caktuar për qarkullim ndërkombëtar.

Neni 4

1. Në rast të humbjes ose dëmtimit të pasaportave diplomatike ose të shërbimit, qytetari i secilit shtet ose palës kontraktuese në territorin e shtetit ose palës tjetër kontraktuese që është mbajtës i

kësaj pasaporte do të njoftojë Ministrinë e Punëve të Jashtme të palës tjetër kontraktuese.

2. Në vend të pasaportave të humbura ose të dëmtuara diplomatike dhe të shërbimit, misioni ose posti konsullor i shtetit, qytetar i të cilit është mbajtësi i kësaj pasaporte, do të lëshojë një dokument të ri udhëtimi.

Neni 5

1. Qytetaret e secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit do t'u përmbahen ligjeve dhe rregullave ekzistuese të palës tjetër kontraktuese gjatë qëndrimit në territorin e atij shteti ose pale kontraktuese.

2. Kjo Marrëveshje nuk kufizon të drejtën e palës kontraktuese për t'i mohuar hyrjen ose për t'ia konsideruar të përfunduar periudhën e qëndrimit në territoret e tyre shtetërore qytetarëve të shtetit ose palës kontraktuese, të cilët ajo mund t'i konsiderojë si "persona të padëshiruar".

Neni 6

1. Palët kontraktuese kanë të drejtë të pezullojnë në mënyrë të përkohshme dhe tërësisht ose pjesërisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për shkaqe që lidhen me rendin dhe sigurinë kombëtare ose shëndetin publik.

2. Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën menjëherë, por jo më vonë se 48 orë nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi vendimin për miratimin dhe përfundimin e këtij pezullimi.

Ky vendim do të hyjë në fuqi 24 orë pas datës së marrjes së këtij njoftimi.

Neni 7

1. Palët kontraktuese do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike modelet e pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit, jo më vonë se 30 ditë përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kur njëra palë kontraktuese lëshon një pasaportë ose bën ndryshime në pasaportat e shkëmbyera, këto ndryshime do të njoftohen nëpërmjet kanaleve diplomatike, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara fillimit të vlefshmërisë së pasaportave të reja ose ndryshimeve të bëra në to, duke bashkëngjitur një model të dokumentit të ri.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë interpretimit ose zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 9

Çdo ndryshim në këtë Marrëveshje do të bëhet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve kontraktuese, si pjesë përbërese e kësaj Marrëveshjeje dhe do të hyjë në fuqi sipas dispozitës së nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për një afat të pacaktuar kohe dhe do të hyjë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi plotësimin e kërkesave të parashikuara në legjislacionin kombëtar të të dyja Palëve Kontaktuese.

2. Secila Palë Kontraktuese mund të përfundojë këtë Marrëveshje, në çdo kohë, duke njoftuar Palën tjetër me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, ndërsa vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje do të ndërpritet 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së marrjes së këtij njoftimi.

Bërë në .... më 2010, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, azerbajxhanase dhe angleze, duke pasur të tria tekstet fuqi të barabartë. Në rast mospajtimesh në interpretim, mbizoterues do të jetë teksti në gjuhën angleze.